



## DEKLARATË PËR SHTYP

### RURAL YOUTH HUB, PLATFORMA E MBËSHTETJES SË AKTIVIZMIT RINOR NË ZONAT RURALE

*Qendra e Rinisë Rurale (Rural Youth Hub – RYH) është një platformë e aktivizmit rinor që mbështet të rinjtë, veçanërisht ata të zonave rurale, që të ushtrojnë zërin e tyre për të ndikuar politikëbërjen bujqësore dhe rurale, për t'i bërë këto procese të orientuara dhe të lidhura ngushtë me shqetësimet, interesat dhe prioritetet e të rinjve.*

Më 22 qershor 2022, 23 të rinj, anëtarë të Rural Youth Hub, nga zona të ndryshme rurale të Shqipërisë, entuziastë të zhvillimit rural organizuan takimin e pestë rrjetëzues dhe shkëmbyes që nga takimi i parë në 11 dhjetor 2019, falë mbështetjes së projektit Rural-You, financuar nga Bashkimi Evropian.

*Të frymëzuar nga përvoja unike e AGLA-CLA – Shoqata e Sipërmarrësve të Rinj Bujqësorë të Konfederatës Italiane të Fermerëve dhe rolin e rëndësishëm që luan në sektorin bujqësor dhe rural në Itali dhe Evropë, falë dy ditëve aktive shkëmbyese me zv Presidentin e AGIA-CIA, Z. Enrico Calentini në Shqipëri (21-22 qershor);*

*Të vetëdijshëm mbi sfidat, nevojat dhe shqetësimet e të rinjve në zonat rurale të vendit, falë organizimit të Asambleve lokale në vitin 2021, që grumbulluan më shumë se 100 të rinj në zonën veriore të Shqipërisë me fokus diskutimin e sfidave;*

*Të ndërgjegjshëm për rolin kyç të rinisë në zonat rurale në zhvillimet sociale dhe ekonomike të vendit, dhe në veçanti në zhvillimet reformuese të sektorit në kuadër të integritimit evropian të vendit tonë;*

*Të sfiduar nga pritshmëritë e larta të shoqërisë për rolin tonë si agjent ndryshimi dhe të fuqizuar përmes njohurive të fituara në kuadër të projektit Rural Albanian Youth (Rural-You) dhe rrjetëzimit në kuadër të platformës së RYH;*

*Të vetëdijshëm mbi vizionin e RYH në zhvillimin e qëndrueshmën rural të vendit;*

*Të motivuar nga praktikatat e mira dhe sipërmarrjet e suksesshme që administrohen nga anëtarët e RYH;*

*Të nxitur dhe të orientuar nga ANRD dhe të mbështetur vazhdimisht në dy vitet e fundit (2021-2022) nga projekti Rural You i financuar nga Bashkimi Evropian, duke mundësuar të rinjtë të përfshihen në zhvillimin e qëndrueshmë të vendit, e në veçanti në transformimin e komuniteteve të tyre rurale përmes RYH.*

**Konkluduar se koha dhe sfidat, kërkojnë politika që pasqyrojnë nevojat dhe përparësitë reale të rinisë rurale, dhe që orientohen nga aspiratat e të rinjve për të ardhmen rurale. Jemi të vetëdijshëm se koha nuk pret dhe finalizimi i procesit të formalizimit të RYH është prioritar drejt një platforme të aktivizmit rinor funksional dhe me ndikim në agjendën zhvillimore dhe integruese të vendit.**

Të rinjtë përgjatë vitit 2021, janë takuar dhe kanë punuar në një qasje pjesëmarrëse rreth misionit, vizionit, objektivave dhe planit të punës të RYH. Ata kanë dakortësuar:

**VIZIONI që do të udhëheqë përpjekjet e të rinjve në RYH është:** Një e ardhme ku rinia rurale kontribuon në mënyrë aktive për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përparimin e komuniteteve rurale të Shqipërisë.

**MISIONI:** Në shërbim të komuniteteve rurale të vendit përmes fuqizimit të të rinjve duke iu ofruar mundësitë për të qenë qytetarë aktivë dhe për të gjeneruar të ardhura dhe mirëqenie edhe në zonën më të largët dhe të varfër rurale, si dhe duke ofruar mundësi për interesin publik.

**VLERAT** e të rinjve pjesëmarrës në Qendër që do ndihmojnë rolin e tyre janë, ndër më kryesoret: Integriteti, Respekti për opinionet e anëtarëve në RYH, Paanësia politike, Nxitës dhe Entuziazmi për të sjellë ndryshim.

**Më 22 Qershor 2022, të fokusuar në nevojën e përmbylljes së procesit të formalizimit ligjor të RYH, të rinjtë pjesëmarrës vendosën të ndjekin këto hapa fillestarë drejt suksesit:**

1. Krijimin e Grupit Teknik i cili do të angazhohet në procesin e formalizimit të RYH. Anëtarët e Grupit Teknik do të mblidhen dhe kontribuojnë rregullisht nën drejtimin e Koordinatorës së RYH me synimin e përfundimit të formalizimit deri në muajin tetor 2022. Procesi do të përfshijë të gjithë anëtarët përmes komunikimi të hapur dhe të rregullt.
2. Promovimi i RYH për të zgjeruar anëtarësinë me të rinj të të gjitha grupeve: sipërmarrës, fermerë, studentë, entuziastë të zhvillimit rural, aktivistë etj;
3. Forcimi i mëtejshëm institucional i RYH si një organizatë me qeverisje të mirë organizative, të hapur dhe transparente në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm rural; finalizimi i kriterëve pranues në RYH dhe organizimi i grupeve tematike brenda RYH;
4. Nxitjen dhe vendosjen e partneriteve me autoritetet publike të sektorit, organizatave të tjera në Shqipëri, rajon dhe BE si dhe me sektorin privat;
5. Përfaqësimin e RYH në Parlamentin e pestë evropian rural që do të organizohet më 12-15 shtator 2022, Kielce, Poloni;
6. Forcimin të marrëdhënjëve me AGIA-CIA me një partneritet të formalizuar drejt ndërkombëtarizimit të aksionit të RYH në nivel Evropian. Aktivitet në kuadër të Rural-You përfshin vizitë studimore në Emilia Romagna në Nëntor 2022.
7. Mundësimin e RYH për të qenë partnere dhe kontribuese e platformës së Parlamentit të tretë Rural Shqiptar, përpjekjet për përgatitjen e të cilës do të fillojnë në fillim të vitit 2023.
8. Organizimin e Asamblesë së parë të RYH në qershor të vitit 2023.

**Kontributi aktiv i të rinjve të zonave rurale përmes RYH do të mundësonte integrimin e perspektivës rinore mbi realitetin rural (në sfida, nevoja dhe aspirata), reflektuar këto në programe, strategji dhe politika të zhvillimit rural dhe bujqësor. Kjo perspektivë e të rinjve mbi realitetin ende nuk është e qartë dhe realiste në politikat e sektorit dhe jo vetëm. RYH do të ofrojë një kontribut të jashtëzakoshëm në këtë drejtim.**

*Për çdo informacion të mëtejshëm, kontaktoni Ilda Metani, Koordinatorë e RYH, në adresën: [ruralityouthbub@gmail.com](mailto:ruralityouthbub@gmail.com). Na ndiqni në <https://anrd.al/rural/>*

*Rural-You është financuar nga [European Union](#) dhe zbatuar nga [Volontari nel Mondo RTM](#), në partneritet [ADAD Malore](#), [Albanian Network for Rural Development](#), [AgroPuka](#), [Partnership for Development Foundation](#), dhe [Association of Young Agricultural Entrepreneurs - Italian Confederation of Farmers](#).*

*Përmbajtja e kësaj deklaratë për shtyp është përgjegjësi e vetme e Konsorciumit zbatues dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin e Bashkimit Evropian.*